



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. Br Prot. <u>01-4927/15</u>
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages <u>02</u>	Data Datum Date <u>28.12.2015</u>



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-02-4171/15, për z. Sinan Bajraktari – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për z. Sinan Bajraktari – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë z. Bajraktari është hetuar për konflikt interesi sepse krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë publik, ka qenë person i autorizuar në biznesin privat D.P.T. Minimarket “Xeli”.

Agjencia kundër Korrupsionit fillimisht zyrtarit i ka dërguar shkresën zyrtare me të cilën e ka njoftuar për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë.

z. Bajraktari është njoftuar me kufizimet në ushtrimin e funksioneve tjera, krahas ushtrimit të funksionit publik dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit. Ai ka premtuar që në afat sa më të shpejt do caktoj një person të autorizuar apo do të mbyllë biznesin privat në mënyrë që të shmang konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se ka mbyllur biznesin privat "Xeli". Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

